



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.49/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevci anëtarë, me zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,300.00 (njëmijetreqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkëngjitur si dëshmi fotografitë e printuara nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 04.06.2017, në rrugën “Johan V Hahn”, në Prishtinë, monitoruesi i tyre ka hasur në postere të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të ngjitur në objekte publike gjegjësisht në transformator të energjisë elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në objekte publike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur tri fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre për kandidatë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të datës 06.06.2017, nuk ka pranuar shkeljen pretenduar në ankesë duke arsyetuar se janë informata propaganduese se në Rrugën “Johan V Han” në Prishtinë, janë ngjitur materiale për kandidatët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe se subjekti në fjalë pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarr masat përmirësuese për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur një foto nga vendi ku është larguar posteri.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të vendosura në objekte publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteret e kandidateve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në objekt publik të qytetit. Të cilën shkelje nuk e ka pranuar subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteret e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në objekt publik. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr posteret në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.49/2017 më datën 06.06.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.